

*Tiranë më 11.12.2021*

**Lënda:** Propozim për vendimarrje Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021

**Drejtuar:** Komisionit të drejtimit të punimeve të Kuvendit Kombëtar

Të nderuar anëtarë të Komisionit të drejtimit të punimeve të Kuvendit Kombëtar,

Në zbatimin të parashikimeve të nenit 43 dhe 60 të Statutit të PDSH, një grup anëtarësh të Këshillit Kombëtar, të cilët janë më shumë se 1/4 e gjithë anëtarëve të tij, sipas firmave bashkëlidhur, propozojnë për miratim projekt ndryshimet në Statutin e PDSH sipas tekstit në aneksin 1 bashkëlidhur kësaj kërkesë.

Për paraqitjen dhe relatimin e ndryshimeve statutore, përpara mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, ngarkojmë për përfaqësim deputetin dhe anëtarin e Këshillit Kombëtar z. Oerd Bylykbashi.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të PD

**ANEKSI 1**

**KUVENDI KOMBËTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**  
**11.12.2021**

**VENDIM**  
**NR. 01 DT 11.12.2021**

Në mbështetje të nenit 60 dhe 43/3 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, me propozimin e një grupi anëtarësh të Këshillit Kombëtar, të cilët përfaqësojnë 1/4 e gjithë anëtarësisë së tij, si dhe me mbështetjen e të paktën 15 përqind të delegatëve, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike

**VENDOSI**

1. Miratimin në parim të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin nen për nen të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin në tërësi të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit**